

FJALA E DEPUTETES EVIS KUSHI

E HËNË 23 MAJ 2022

E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuara kolegë,

Nuk po ndalem në detajet e projektligjit të Butrintit, sepse edhe ministrja e Kulturës, edhe kolegët parafolës ishin shumë shtrues në lidhje me perspektivën pozitive që ky projektligj hap jo vetëm për Butrintin, por për një zonë shumë më të gjerë, por dua ta trajtoj pak më gjerë çështjen dhe më pas të ndalem në disa modele pozitive në fushën e arsimit. Së pari, më vjen keq të konstatoj që çdo herë, kur ka projekte të reja, kur ka iniciativa të reja, kur ka punë të mira opozita, ose më saktë përfaqësues të opozitës, sepse jo e gjithë opozita është njësoj, në rastin më të mirë, e paragjykon projektin dhe, në rastin më të keq, hedh akuza, hedh baltë, sajon dhe shpif.

Kjo është një de ja vu. E kemi parë te Parku i Liqenit, e kemi parë te Pazari, por edhe në plot rrugë dhe investime të tjera. Por në çdo rast është vërtetuar se si ka përfunduar. Projektet janë realizuar, qytetarët shijojnë frytet e projekteve dhe ndërkohë është vërtetuar që ka qenë thjesht luftë politike. Ne kemi jo vetëm luftë politike opozita kundër maxhorancës, por shpeshherë opozita edhe kundër institucioneve të pavarura, opozita kundër prokurorëve e gjykatësve, opozita kundër ambasadorëve, madje kohët e fundi opozita sulmon edhe investimet e huaj, sulmon edhe partnerët tanë ndërkombëtarë, solidaritetin dhe mbështetjen e tyre për institucionet tona, për vendin, për qytetarët, kjo është përtej çdo imagjinate.

Ne u jemi shumë mirënjohës të gjithë partnerëve tanë, në çdo rast, madje shpresojmë në mirëkuptimin e tyre, që edhe kur hidhet baltë mbi ta, ta kuptojnë që nuk janë ata qëllim në vetvete, por është gjithmonë ajo loja e vjetër, ajo loja e verbër, ajo loja e dalë boje, ku interesi personal dhe partiak vendoset mbi interesin e Shqipërisë, mbi interesin e qytetarëve. Ne gjithsesi, nuk dekurajohemi, por përkundrazi do të vazhdojmë bashkëpunimin me partnerët tanë dhe nuk do të reshtim së shprehuri mirënjohjen ndaj tyre, edhe në emër të qytetarëve, madje edhe në emër të qytetarëve të djathtë, që votojnë këtë opozitë, e cila bën këtë politikë të verbër.

Më lejoni që të ndalem në disa modele që lidhen me fushën e arsimit, ku mbështetja e Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim ka qenë e vazhdueshme, e qëndrueshme dhe ndoshta, më shumë se në

çdo sektor tjetër, ka pasur projekte me impakt të lartë në rritjen e cilësisë së arsimit. Projektet tona janë vërtet modele suksesi. Unë do të përmend modele që tashmë janë të konsoliduara prej vitesh, por edhe modele të reja, që vetëm para pak ditësh i kemi miratuar. E para, Shkolla e Drejtorëve, e krijuar që prej vitit 2019, me mbështetjen e Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, synon të zhvillojë kapacitete drejtuese, menaxheriale të drejtorëve dhe nëndrejtorëve të shkollave tona, me modulet më të mira teorike dhe praktike, të huazuara nga modelet më të mira të shkollave të lidershipit, që janë sot në botë, dhe me ekspertë të kualifikuar, që e zhvillojnë këtë program trajnimi të detyrueshëm për drejtuesit e institucioneve tona arsimore.

Për rëndësinë që ka ky program i trajnimit të detyrueshëm, ne e kemi përfshirë në ligjin “Për arsimin parauniversitar”. Deri tani janë diplomuar 3 breza, me rreth 334 pjesëmarrës, ku janë jo vetëm drejtorë dhe nëndrejtorë shkollash, por janë edhe aspirantë për t’u bërë nesër drejtues institucionesh. Ndërkohë, ka filluar brezi i katërt, me rreth 300 pjesëmarrës e kështu me radhë. Projekti i dytë, “Junior Achievement në Shqipëri”. Cili është misioni i këtij programi? Misioni i tij është që t’i pajisë nxënësit me aftësi për ekonominë dhe sipërmarrjen. Është program shkollor, modulet e të cilit janë përfshirë në kurrikulën bërthamë, në lëndën e qytetarisë, në lëndën e ekonomisë, edhe ky një rast suksesi. “Junior Achievement of Albania” ka marrë edhe çmime ndërkombëtare për kontributin që jep në arsimimin e nxënësve dhe pajisjen e tyre me aftësitë që kërkon shekulli i 21.

Po kaloj te programet e reja, të cilat kanë pak ditë që i kemi miratuar. Këshilli i Ministrave dhe Fondacioni Shqiptaro-Amerikan nënshkruan para pak ditësh marrëveshjen, që ka si qëllim pilotimin e lëndës së teknologjisë së informacionit, komunikimit dhe kodimit që nga klasa e parë. Fillimisht projekti do të pilotohet në 100 shkolla të vendit, të cilat po pajisen me laboratorë smart, më pas, vitin e ardhshëm, do të kemi mundësi dhe do të punojmë fort që këtë projekt ta zgjerojmë edhe në shumë shkolla të tjera të vendit. “Inteligjenca artificiale për të rinjtë”, është një tjetër projekt që para pak ditësh e ka nënshkruar Ministria e Arsimit dhe e Sportit me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim. Ky projekt ka për qëllim aftësimin e nxënësve nga mosha 13 deri në 19 vjeç me teknologjinë e avancuar dhe inteligjencën artificiale. Edhe ky projekt do të pilotohet në 5 shkolla, në të cilat po ndërtohen laboratorët e inteligjencës artificiale, mësuesit po trajnohen me ekspertët më të mirë të “Intel Corporation”, e cila është kompania që po e zbaton këtë program edhe në 11 vende të tjera.

Synimi dhe ambicia jonë është që ta shtrijmë këtë projekt edhe në shkolla të tjera. Gjithmonë filozofia e bashkëpunimit tonë me Fondacionin Shqiptaro – Amerikan për Zhvillim është që të fillojmë me hapa më të vegjël, por, pasi të konsolidohen dhe të sigurohemi që janë të suksesshme, do t’i shtrijmë në të gjithë

vendin. E fundit, para tri ditësh kemi nënshkruar marrëveshjen për programin RID, që do të thotë ekspertizë shkencore nga diaspora akademike. Në dhjetor të vitit të kaluar Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim nënshkroi marrëveshje me tri universitetet e mëdha publike në vend: Universitetin e Tiranës, Universitetin Politeknik dhe Universitetin e Mjekësisë.

Kjo marrëveshje na jep mundësi të ftojmë diasporën akademike dhe shkencore të japin kontributet e tyre për universitetet tona. Gjithashtu, para pak ditësh e zgjeruam këtë bashkëpunim edhe me 11 universitete të tjera publike në vend. Praktikisht, pothuajse të gjitha universitetet publike po hapin dyert për diasporën akademike për të na dhënë kontribut për rritjen e cilësisë së mësimdhënien, rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor dhe objektivin primar që ne kemi: ndërkombëtarizimin e universiteteve. Pikërisht diaspora akademike do të jetë urë bashkëpunimi midis universiteteve tona dhe universiteteve më prestigjioze europiane dhe botërore. I përmenda këto detaje si shembuj pozitivë për të vlerësuar kontributin e partnerëve tanë, për të parë se sa punë të mira kemi bërë së bashku, sikurse do të vazhdojmë të bëjmë, por edhe sepse janë modele pozitive, të cilat shërbejnë si garanci për projekte të reja, duke përfshirë edhe projektin për Butrintin.

Nisur nga suksesi i të gjitha marrëveshjeve dhe bashkëpunimeve të deritanishme me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për zhvillim, por edhe nga procesi i plotë, nga analiza dhe konsultimi që ka kaluar projektligji për Butrintin, unë jam besimplotë se edhe ky do të jetë një model suksesi që, pse jo, mund shtrihet edhe në fusha të tjera. Si në çdo rast, duhet vetëm pak durim. Koha tregoi se, edhe pse luftuan kundër ndërtimit të parkut te liqeni, ata sot shëtisin me fëmijët dhe prindërit e tyre, bëjnë vrap ose shëtitje me biçikletë. Nuk e di nëse skuqen apo jo sot, kur dalin shëtitje në atë park, por rëndësi ka që ne të gjithë bashkë të shijojmë frytet e këtyre projekteve dhe të angazhohemi më fort për projekte të reja në të ardhmen. Faleminderit!